



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 618/2 Prot.

Durrës, më 05.03.2026

VENDIM

Nr. 23, datë 05.03.2026

PËR

**"DHËNIEN E TITULLIT "DOCTOR HONORIS CAUSA"
Z. NICOLAS BERGGRUEN"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", kreu V, pika 1; referuar shkresës së Rektorit nr. 60/1 prot., datë 12.01.2026 "Mbi dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa", për Z. Nicolas Berggruen"; shkresës së Ministrisë së Arsimit Nr. 60/3 prot, datë 26.01.2026, si dhe në relacionin nr.60/4 Prot., datë 27.01.2026 të Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Studentore, në mbledhjen e datës 05.03.2026, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa" Z. Nicolas Berggruen nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, me motivacion:
"Në vlerësim të kontributit të tij global në fushën e filozofisë dhe politikave publike, në ndërtimin e urave ndërmjet mendimit teorik dhe praktikës së qeverisjes, si dhe për përkushtimin e tij në promovimin e dialogut ndërkombëtar, etikës dhe bashkëpunimit akademik në nivel botëror".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtoria e Projekteve dhe Mardhënieve me Jashtë
 - Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Studentore
 - Grupi i punës për organizimin e ceremonisë "Doctor Honoris Causa"
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

